

Znj. Denada Seferi ka lindur në Tiranë, në 27 Dhjetor 1972. Ajo ka përfunduar studimet e larta në Universitetin e Tiranës, me diplomë universitare dhe master në gjuhë dhe letërsi italiane, duke ndjekur dhe studime pasuniversitare në Siena, Itali. Në vitin 2013 ka ndjekur për 3 vjet studimet në nivelin Master dhe diplomohet në "Qeverisje dhe Zhvillim Territorial" për administratën publike.

Që prej vitit 2010 është angazhuar si pedagoge me kohë të pjesshme në Fakultetin e Shkencave Sociale në lëndën "Demografi Sociale" dhe "Vlerësimi i Shërbimeve Sociale".

Në vitin 2022 fiton titullin "Doktor i Shkencave" pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës.

Znj. Denada Seferi, ka shërbyer në Administratën Publike prej vitit 1996, duke mbajtur pozicione të ndryshme në nivel drejtuesi në administratën publike të Republikës së Shqipërisë në fushat e shërbimit dhe përkujdesjes sociale, integritit social-ekonomik, të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve, procesit të birësimit, migracionit, zhvillimit të shoqërisë civile dhe bashkëpunimit institucional ndërkombëtar.

Ka përvojë të gjerë në drejtimin e praktikave politikëbërëse dhe vlerësimit institucional në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare si Banka Botërore, Organizatat e Kombeve të Bashkuara si në Shqipëri dhe në rajon.

Themeluese programesh në fushën e mbrojtjes sociale, sistemet e vlerësimit të aftësisë kufizuar dhe shërbimeve alternative.

Aftësi të larta në menaxhimin e bazuar në rezultate (RBM), buxhetimin, vlerësimin dhe monitorimin e programeve dhe zhvillimin strategjik.

Prej Tetorit 2021, Znj. Seferi shërben si Zëvendës Ministre në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duke mbajtur në portofolin e saj çështjet sociale dhe çështjet e integritit evropian si pjesë e Grupit Negociator për aderimin e Republikës së Shqipërisë në BE.